

# INDEKSI I VLERËS SË SHITJEVE NETO NË INDUSTRI

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure  
(ESMS)

INSTAT

## Metadate Referenciale

Metadate Referenciale.....	1
1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore .....	2
4. Njësia matëse .....	3
5. Periudha e referencës .....	3
6. Mandati institucional.....	3
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes .....	5
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	5
11. Manaxhimi i cilësisë .....	6
12. Rëndësia .....	6
13. Saktësia dhe besueshmëria .....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	8
15. Koherenca dhe Krahueshmëria .....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor .....	10
19. Komente .....	11
Aneks .....	11

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Elma Çali
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës, Sektori i Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr.2, 1017, Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:ecali@instat.gov.al">ecali@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	18.03.2024
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	18.03.2024
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	18.03.2024
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Indeksi i Vlerës së Shitjeve Neto në Industri është një tregues tremujor afatshkurtër i përdorur për analizën e ciklit të biznesit. Burimi kryesor për Indeksin e Vlerës së Shitjeve Neto në Industri është Vrojtimi Tremujor i Statistikave Afatshkurtra (Moduli 121) kombinuar me të dhëna administrative.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi statistikor i aktiviteteve ekonomike bazohet në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike <a href="#">NVE Rev.2.</a>
3.3. Mbulimi i sektorit	Vrojtimi për këtë indikator përfshin ndërmarrjet e klasifikuara në Seksionet B, C, D dhe E të NVE Rev. 2. Vrojtimi përfshin të gjitha ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme, si dhe një numër përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla. Një shtresë përcaktohet sipas klasave dhe bazohet në numrin e të punësuarve.

3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	Objektivi i Indeksit të Vlerës së Shitjeve Neto në Industri është të tregojë zhvillimin e tregut të mallrave dhe të shërbimeve. Shitjet neto përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësi që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve ndaj palëve të treta. Gjithashtu përfshin të gjitha tarifatat e tjera (transporti, paketimi, etj.) të kaluara tek klienti, edhe nëse këto tarifa janë renditur veçmas në faturë. Shitjet neto përjashtojnë taksën mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe taksat e tjera të ngjashme të zbritshme të lidhura drejtpërdrejt me shitjet neto si dhe të gjitha detyrimet dhe taksat për mallrat ose shërbimet e faturuara nga njësi. Indekset e Vlerës së Shitjeve Neto të Brendshëm dhe të Eksportit kërkojnë që shitjet të ndahen sipas destinacionit të parë të produktit bazuar në ndryshimin e pronësisë. Destinacioni përcaktohet nga vendi rezident i palës së tretë që ka blerë mallrat dhe shërbimet. Të dhënat në lidhje me Indeks të Vlerës së Shitjeve Neto të Brendshëm dhe atë të Eksportit janë mbledhur, por nuk publikohen.
3.5. Njësia statistikore	Njësia e vrojtuar është ndërmarrja.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin njësitë statistikore, ndërmarrje, të cilat operojnë në aktivitete ekonomike sipas NVE Rev. 2, Industri (seksionet B, C, D dhe E, përkatësisht ndarjet 05-39). Ndërmarrjet me 1-9 të punësuar janë vrojtuar me kampion, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë vrojtuar tërësisht.
3.7. Zona e referencës	Indeksi i Vlerës së Shitjeve Neto në industri mbulon gjithë territorin e Shqipërisë në nivel kombëtar.
3.8. Mbulimi në kohë	Vrojtimi tremujor i Statistikave Afatshkurtra referuar Indeksit të shitjeve në industri, datojnë prej vitit 2005 e në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Viti bazë: 2015=100, aplikohet duke filluar nga tremujori i parë 2019.
<b>4. Njësia matëse</b>	Njësitë matëse janë indekset dhe ndryshimet në përqindje (%).
<b>5. Periudha e referencës</b>	Informacioni i grumbulluar dhe përpunuar i referohet periudhave tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2023.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore ku mbështeten indikatorët e statistikave afatshkurtra konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a></li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026</a></li> </ul> <p>Klasifikimet dhe Përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Rregullorja e Këshillit Nr.1165 / 98</a> duke prezantuar Statistikat afatshkurtra në nivel Evropian</li> <li>• <a href="#">Rregullorja e Komisionit Nr.1503 / 2006</a> e cila përcakton variablat</li> </ul>

	dhe shpeshhtësinë e përpilimit të të dhënave, shfuqizimi i porosive të reja të marra për ndërtimin e ndërtesave dhe porosinë e reja të marra për inxhinierinë civile.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Transmetimi i të dhënave për Statistikat Afatshkurtra ka filluar në tremujorin e tretë të vitit 2017 në nivelin Evropian. Nga tremujori i parë i vitit 2018 të dhënat për treguesit kryesorë transmetohen rregullisht në Eurostat. Transmetimi i të dhënave me Eurostat nuk ka filluar ende, sepse Indeksi i Vlerës së Shitjeve Neto në Industri bazohet në periudha tremujore.
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 Për Statistikat Zyrtare , si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:  a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregulloren, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose  b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;  Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktuara shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomanduara se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.

<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat njoftohen paraprakisht në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	<a href="#">Kalendarin</a> e publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesin e përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Seksioni <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a> , për përdoruesit e jashtëm.
<b>9. Shpeshtësia e shpërndarjes</b>	
	Indeksi i Vlerës së Shitjeve Neto në Industri shpërndahet me bazë tremujore.
<b>10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Statistikat Afatshkurtra. Formatin e njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Statistikave Afatshkurtra publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT nën nëntemën: <a href="#">Statistikat Afatshkurtra</a> .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e Statistikave Afatshkurtra. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: <a href="#">Databaza Statistikore</a>
10.4. Aksesin në të dhëna mikro	Të dhënat në nivel mikro nuk bëhen të disponueshme, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për statistikave zyrtare".

10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kontakt</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">Metodologjinë</a> mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ATN për qëllime të brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për statistikat Zyrtare”, Nr.17/2018, datë 17.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane ( <a href="#">European Statistics Code of Practice</a> ). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për përlllogaritjen e indeksit dhe është i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollet fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollet përfundimtare.</p> <p>Është bërë një krahasim me të dhënat e vitit të kaluar për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha.</p>
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit janë klasifikuar në të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <p><b>Përdoruesit e jashtëm janë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministritë dhe administrata publike që përdorin të dhënat për qëllime të planifikimit të politikave ekonomike dhe sociale.</li> <li>• Universitetet (profesorë/studentë të diplomuar dhe pasuniversitar), organizata kërkimore.</li> <li>• Organizatat jofitimprurëse Kombëtare dhe Ndërkombëtare</li> <li>• Ndërmarrjet</li> <li>• Publiku i gjerë që merr informacionin përmes mediave masive përmes publikimeve të bëra nga Zyra e Statistikave.</li> </ul>

	<p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Llogarive Kombëtare</li> <li>• Sektori i Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve</li> <li>• Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>INSTAT analizon çdo vit klikimet e faqes web dhe klikimet në lidhje me temën “Statistikat Afatshkurtra” për vitin 2023 janë 9.580.</p> <p>INSTAT kryen çdo vit vrojtimin për matjen e <a href="#">Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p> <p>Rezultatet e vrojtimit për 2023 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës “Statistikave Afatshkurtra” është vlerësuar me 3.90 (78.0%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Për sa i përket plotshmërisë së Statistikave Afatshkurtra, ajo ndërtohen në përputhje me rregulloret e Eurostat. Shkalla e plotshmërisë së të dhënave të vrojtimit të Statistikave Afatshkurtra për vitin 2023 është 70.6%. Kjo llogaritje bazohet në rregulloret evropiane. Si rezultat, llogaritja e Indeksit të Vlerës të Shitjeve Neto në Industri dhe të dhënat e siguruar janë në përputhje me Rregulloret përkatëse të BE-së.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave.</p> <p>Popullata e vëzhguar e Statistikave Afatshkurtra 2023 përfshin afërsisht 11,500 ndërmarrje për çdo tremujor nga të cilat afërsisht 2,500 në aktivitetin Industri. Dizajni i kampionimit është kampionim i thjeshtë i rastësishëm, i shtresëzuar. Kriteri i përdorur për shtresëzim është numri i punonjësve sipas NVE Rev.2 në nivel 3 shifror.</p> <p>Llogaritja e vlerësimeve të të dhënave statistikore dhe analiza e njesive outlier kryhet rregullisht. Shkalla e saktësisë së përgjithshme është e lartë, duke marrë parasysh shkallën e lartë të përgjigjes. Për të llogaritur vlerësimet, përdoret vlerësuesi Horvitz-Thompson, që është i paanshëm. Saktësia e vlerësimeve arrihet duke eliminuar gabimet e kampionimit dhe të jo kampionimit, të tilla si mbulimi, pa përgjigje, gabimet e përgjigjes dhe gabimet e përpunimit.</p> <p>Arsyet e shfaqes së gabimeve në mbulim janë keq klasifikimi i njesive dhe ndryshimet në statusin e njesive raportuese. Është e detyrueshme t’i përgjigjesh vrojtimit. Në rast mos-përgjigje, njësitë kontaktohen përmes telefonit dhe postës elektronike. Gabimi në kampionim në përqindje (CV) llogaritet për treguesit kryesorë të vrojtimit që publikohen çdo tremujor.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Gabimet e kampionimit trajtohen në raportet e brendshme teknike, ku për çdo indikator në vrojtimit llogaritet varianca e totalit, si dhe gabimi standart relativ, për eliminimin e efektit negativ që jep lëvizja e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes në serinë kohore të vlerave. Të gjitha vlerat e treguesve</p>



	përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p><b>Mos-përgjigja në nivel rekordi</b> merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën.</p> <p><b>Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi</b> mesatarisht për ATN 2023 është 3.58%.</p>								
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Indeksit të Vlerës së Shitjeve Neto në Industri janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 78 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 78 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Indeksi i Vlerës së Shitjeve Neto në Industri është 31 Dhjetori 2023.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/18/2024</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>78</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e publikimit	3/18/2024	Afatet kohore	78		
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e publikimit	3/18/2024								
Afatet kohore	78								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Indeksi i Vlerës së Shitjeve Neto në Industri, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Indeksi i Shitjeve Neto në Industri ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>3/18/2024</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/18/2024</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e shpallur	3/18/2024	Data e publikimit	3/18/2024	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e shpallur	3/18/2024								
Data e publikimit	3/18/2024								
Vonesa në kohë	0								
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Të dhënat për Indeksi i Vlerës së Shitjeve Neto në Industri janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.</p>								
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Ndër vite Indeksi i Vlerës së Shitjeve Neto në Industri ka pësuar ndryshime në fushën e mbulimit dhe në metodën e zgjedhjes. Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve ka filluar për herë të parë në vitin 2005. Ndërmarrjet më 1-9 të punësuar janë me kampionim, ndërsa ndërmarrjet me mbi 10 të punësuar janë marrë me listim (në mënyrë ekzostive) pa ndryshuar fushën e mbulimit. Në vitin 2012 ndryshon popullsia si rezultat i përditësimit të Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve me rezultatet e Rregjistrimit të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2010. Të gjitha ndryshimet janë raportuar në shpjegimet metodologjike që shoqërojnë publikimet përkatëse. Në vitin 2014 në Indeksin e Vlerës së Shitjeve Neto në Industri u implementua nomenklatura e aktiviteteve ekonomike, NVE Rev. 2, struktura e azhornuar e peshave dhe ndryshimi i periudhës bazë të indekseve nga 2005 në 2010. Në vitin 2019 në SASH përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2010 në 2015 Të gjitha këto ndryshime</p>								



	<p>në serinë e indekseve nuk janë shkëputur, por indekset janë hedhur përsëri. Këto ndryshime raportohen në shpjegimet metodologjike që bashkohen me botimet përkatëse. Të dhënat e Statistikave afatshkurtra sipas tremujorëve bazuar në Klasifikimin e Aktivitetit Ekonomik NVE Rev 2, datojnë që nga viti 2006 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 18 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=18).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Indeksi i Vlerës së Shitjeve Neto në Industri është vlerësuar duke përdorur të dhënat e TVSH. Për ndërmarrjet që të dhënat e TVSH nuk janë të disponueshme është përdorur vërtetim me zgjedhje. Nuk ekziston informacion tjetër statistikor i cili mund të përdoren për kontrollin e koherencës.</p>
15.4. Koherenca e brendshme	<p>Koherenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar përpara se ato të finalizohen. Lidhja midis variablave është kontrolluar dhe koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave është konfirmuar. Specialistët e Statistikave afatshkurtra punojnë së bashku me specialistë të drejtorive përkatëse për të siguruar qëndrueshmërinë dhe koherencë të treguesve statistikor.</p>
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Kostoja e Statistikave Afatshkurtra përfshin informacion mbi numrin e stafit të përhershëm dhe të përkohshëm. Numri i stafit të ATN është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Totali i stafit në Zyrën Qendrore: 1 punonjës</li> <li>• Specialistët e logjistikës 1 punonjës</li> <li>• Kontrollorë 9 të punësuar</li> <li>• Operatorë 9 të punësuar</li> <li>• Anketues 144 të punësuar</li> </ul> <p>Transmetimi i të dhënave administrative mundësohet pa kosto përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara midis INSTAT, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Burimet Statistikore (Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ATN e mëparshme) janë gjithashtu pa kosto, pasi janë konsideruar si përdorues të brendshëm. Stafit i ATN menaxhon kontrollin dhe analizën e të dhënave, kështu që edhe këto dy procese nuk kanë kosto të tjera shtesë.</p>
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantuara nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul> <p>E njëjta politikë revizionimi aplikohet ndaj publikimeve dhe transmetimeve kombëtare në Eurostat.</p>

17.2. Praktika e rishikimit	<p>Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare ato mund të rishikohen. Të dhënat mund të rishikohen për një sërë arsyesh si: implementimi i klasifikimit të ri NVE, ndryshime metodologjike, burime të reja informacioni ose të përmirësimeve të të dhënave dhe korrigjime të gabimeve. Rishikimi i tremujorit paraardhës është i mundur të kryhet gjatë çdo tremujori dhe në fund të çdo viti mund të kryhen korrigjime për të katërt tremujorët.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Indeksi e Vlerës së Shitjeve Neto” për vitin 2023. Nuk ka vlerësime numerike të indikatorëve MR dhe MAR.</p>
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Të dhënat bazohen në anketat statistikore tremujore dhe të dhënat administrative. Baza e përzgjedhjes është Regjistri i ndërmarrjeve aktive për vitin referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev. 2. Popullata në studim përcaktohet nga dy kriteret themelore: Madhësia e ndërmarrjes (bazuar në numrin e të punësuarve) dhe aktiviteti ekonomik brenda fushës së studimit, me prerje. Metoda e përdorur e përzgjedhjes është Përzgjedhje e thjeshtë e Rastit me Shtresëzim (SRS). Shtresëzimi bazohet në kombinimin e aktivitetit ekonomik me grupin e madhësisë së ndërmarrjes. Treguesit janë paraqitur për aktivitete ekonomike sipas fushave të përcaktuara në rregulloren e Statistikave Afatshkurtra dhe gjithashtu bazuar në nevojat e përdoruesve.</p>
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mblidhen çdo tremujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Të dhënat janë siguruar në mënyrë të kombinuar nëpërmjet burimeve administrative dhe intervistimit të drejtpërdrejtë nga anketuesit pranë ndërmarrjeve. Kohëzgjatja e intervistimit të drejtpërdrejtë ishte 15 ditë pas tremujorit referues dhe u krye vetëm për ndërmarrjet të cilat nuk ishin subjekt i deklarimit në burimet administrative.</p> <p>Gjatë vitit referencë nuk është planifikuar ndryshim në pyetësor.</p>
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Të dhënat e marra nga vrojtimi dhe nga skedari i TVSH-së vlerësohen duke përdorur rregulla logjike të vlefshme. Në nivel kombëtar, editimi përfshin studimin e të dhënave të të anketuarve me qëllim identifikimin (dhe korrigjimin) e gabimeve. Jo të gjitha gabimet mund të identifikohen, por qëllimi është të zbulohen ato gabime që kanë ndikim të madh tek rezultatet. Rregullat për identifikimin e gabimeve mund të vënë në dukje gabime të mundshme të cilat kërkojnë një studim të mëtejshëm për të kuptuar se ku qëndron gabimi përkundrejt një rezultati të pazakontë ose mund të evidentojnë gabime të përcaktuara. Redaktimi (editimi) përfshin kontrollë për tërësinë, që vlerat janë brenda kufijve të caktuar dhe se vlerat për variablat e lidhur janë koherent. Redaktimi i të dhënave mund të bëhet gjatë ose pas hedhjes së të dhënave. Përgjigjet mund të krahasohen me përgjigjen e tremujorëve të mëparshëm. Mospërputhja ose devijimet e mëdha (jashtë një diapazoni të paracaktuar) tregojnë se një studim më i thellë do ishte i rëndësishëm. Kjo mund të rezultojë në redaktim të dhënash. Në kontekstin e afatit kohor, procesi i redaktimit mund</p>

	<p>të jetë i dizajnuar për t'i dhënë përparësi kryesore atyre njesi outlier që kanë më shumë nevojë për redaktim për hir të agregateve të besueshëm. Me zgjidhjen e rasteve më të këqija, mund të arrihen përmirësime të mëdha.</p>
<p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p><b>Nivel Kombëtar</b></p> <p>Hapi i parë është mbledhja e informacionit nga të dhënat administrative dhe intervistave të drejtpërdrejta me ndërmarrjen. Qëllimi është për të sjellë këtë informacion në nivelin statistikor. Proçesi i ndjekur është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli fizik i pyetsorëve (verifikimi i plotësimit të pyetsorëve sipas standarteve të skanimit)</li> <li>• Kontrolli logjik i pyetsorëve (kontrolli i shënjitimit logjik të indikatorëve të përgjigjes, përshkrimit të aktivitetit dhe kodifikimit si dhe kontrolli i plotësimit të shifrave)</li> <li>• Pas hedhjes së të dhënave, gabimet dhe mospërputhjet evidentohen dhe korrigjohen përgjatë redaktimit (editimit).</li> <li>• Mos-përgjigjet dhe mungesa e informacionit për ndërmarrjet e rëndësishme (ndërmarrjet e mëdha) duhet të plotësohen nëpërmjet proçesit të imputimit duke përdorur informacionin e marrë nga burime të tjera.</li> <li>• Krahasueshmëria e të dhënave (ndërmjet të dhënave të vrojtimit dhe të dhënave administrative, periudhat e mëparshme ose trendet).</li> <li>• Analiza e rezultateve për çdo fushë publikimi (domein).</li> <li>• Rezultatet e plota dhe të pastra të të dhënave shërbejnë më pas për fazën e peshimit dhe ri-peshimit</li> <li>• Të dhënat e agreguara krahasohen me të dhëna nga burime të tjera</li> <li>• Dy fazat e fundit mund të jenë subjekt analizash të tjera, në funksion të rezultateve sipas fushave të publikimit (domein-et).</li> </ul> <p>Së fundi, kur analiza statistikore ka përfunduar, këto të dhëna përcaktohen si grup informacioni jo-publike. Para shpërndarjes së rezultateve, fazë shumë e rëndësishme është ruajtja e konfidencialitetit të këtij informacioni.</p>
<p>18.6. Rregullimi</p>	<p>Indeksi i Vlerës së Shitjeve Neto në Industri llogaritet i përshtatur sezonalisht dhe i papërshtatur sezonalisht.</p> <p>Përshtatja sezonale e serive kohore tremujore të Statistikave Afatshkurtra u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.0. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori IV 2023. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative) dhe qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.</p>
<p>19. Komente</p>	
<p><b>Aneks</b></p>	